

Nr. Prot. 60 KD
Datë 11.02.2025

DEKLARATË

Lënda: Lidhur me procedurën e shkarkimit të anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTSH-së

DREJTUAR: Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Kuvendi i Shqipërisë

Znj. Ina ZHUPA, kryetare e Komisionit

Për dijeni: Znj. Elisa SPIROPALI, kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Tiranë, më 11.02.2025

E nderuar znj. Zhupa,

Duke Ju përcjellë ndjenjat e konsideratës sonë të lartë, ne, një grup anëtarësh të Këshillit Drejtues të Radio Televizionit Shqiptar, të njoftuar për nisjen e procedurës së shkarkimit nga Komisioni parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, ju parashtrojmë sa më poshtë vijon:

Në vlerësimin tonë, procedura e shkarkimit të anëtarëve të Këshillit Drejtues, në mënyrë kolektive, me nxitim dhe në shkelje të procedurave ligjore, është ndikuar nga veprimet antiligjore të kryetarit të Këshillit Drejtues, përfshirë edhe procedurën e fundit të zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së.

Kjo procedurë është nismuar nga kryetari i KD, është drejtuar nga ai në disa seanca mbledhjeje, vendimi është lexuar edhe publikisht nga z. Bungo, por vetëm pasi u konstatua mospasja e kandidatit të preferuar të kryetarit të Këshillit, gjithçka u anatemua dhe u quajt e paligjshme.

Ne anëtarët e Këshillit Drejtues, kemi ndjekur dhe përjetuar me shqetësim të thellë qëndrimin dhe sjelljen e kryetarit Leka Bungo, i cili gjatë gjithë periudhës së drejtimit prej katër vitesh ka krijuar probleme të shumta e serioze në mbarëvajtjen e institucionit tonë, ndonëse përpjekjet e anëtarëve të Këshillit Drejtues, gjatë gjithë periudhës, kanë qenë për durim e qetësi, duke përcjellë mesazhe bashkëpunimi e tolerance ndaj kryetarit të Këshillit, por kanë ndeshur në arrogancën, brutalitetin dhe shkeljen flagrante të normave etike nga zoti Bungo.

Këshilli Drejtues është penguar në mënyrë të qëllimshme në komunikim institucional me Komisionin parlamentar dhe Drejtorinë e Përgjithshme, duke bërë që shumë vendime e analiza të rëndësishme që duheshin marrë brenda afateve ligjore, të tejkalohen, gjë që penalizon gjithë procesin normal të funksionimit të RTSH-së.

Në këtë kuadër, kemi konstatuar se, kërkesa dhe shkresa të shumta të ardhura në adresë të Këshillit Drejtues nga Komisioni i Medias dhe Drejtoria e Përgjithshme, janë mbajtur të fshehura në mënyrë të qëllimshme nga z.Bungo, duke sjellë një ngërç dhe pasoja për institucionin.

Ne anëtarët e Këshillit Drejtues konstatojmë se z. Bungo është ai që e ka shkelur ligjin në mënyrë të përsëritur dhe është në konflikt të hapur interesi me përfitimet e padrejta që ka marrë, duke firmosur e zeza mbi të bardhë për projekte në RTSH, çfarë është e ndaluar rreptësisht;

Ne, anëtarët e Këshillit Drejtues, kundërshtojmë plotësisht procedurën e shkarkimit të anëtarëve, duke e konsideruar si një vendim politik dhe në kundërshtim të hapur me ligjin.

Pas dëgjësës së javës së shkuar, ne u treguam të gatshëm dhe me angazhim qytetar, profesional e ligjor, sipas sugjerimit Tuaj, për të vijuar komunikimin me Komisionin Parlamentar, në funksion të gjetjes së zgjidhjes më të mirë për situatën e krijuar. Ky angazhim i yni nuk u mor parasysh.

Në dëgjësën e Komisionit, ne u shprehëm dhe jemi të gatshëm për çdo qartësim të papajtuësive të pretenduara, në bazë kuadrit ligjor në fuqi,

Mbështetur në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutin e RTSH-së, ne do të ndjekim të gjithë hapat ligjorë për kundërshtimin e çdo vendimi të kundërligjshëm.

Mbetemi të bindur që kërkesa jonë do të vlerësohet dhe merret në konsideratë.

Duke Ju falënderuar,


Milena Selimi



Albert Minga



Edmond Tullumani



Ilir Keko

